

VENDIM
Nr. 90, datë 15.7.2015

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E RREGULLORES MBI
PROCEDURAT PËR CERTIFIKIMIN E OPERATORIT TË SISTEMIT TË
TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR**

Bazuar në nenin 9 të ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, nenet 7 dhe 149 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, të ratifikuar me ligjin nr. 9501, datë 3.4.2006, “Rregullat për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, vendimit të Këshillit Ministerial nr. D/2011/02/MC-EnC, si dhe në përputhje me direktivën 2009/73-EC dhe rregulloren EC nr. 715/2009, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.7.2015, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga grupi i punës të rregullores “Për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të gazit natyror” dhe relacionin përkatës, për fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e rregullores “Për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të gazit natyror”,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e rregullores “Për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti